



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE

K R Y E S I A

Nr. 391 / 1 prot.

Tiranë, më 24.10. 2019

V E N D I M

Nr. 25 datë 24.10.2019

Kryesia e ASH-së në mbledhjen e saj të datës 24.10.2019, me pjesëmarrjen e Kryetarit, Zëvendëskryetarit, dhe dy kryetarëve të seksioneve, në zbatim të nenit 12, pika 2, të ligjit nr.53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 33 të Statutit,

V e n d o s i:

1. Fillimin e procedurës, marrjen e mendimeve dhe konsultimet me anëtarët e Asamblesë, për ngritjen e Komisioneve të përhershme të ASH, për caktimin e numrit, emërtimin dhe funksionimin, në bashkëpunim me seksionet shkencore sipas variantit të parë të Kryesisë për 8 komisione.

2. Komisionet propozohet të jenë si më poshtë:

- Pranë Seksionit të Shkencave Natyrore Teknike, të ketë 4 komisione me emërtimet:

Shkencat e informacionit dhe matematika
Shkencat kimi, biologji, dhe bioteknologji
Shkencat fizike dhe mjedisore
Shkencat inxhinerike dhe nanoteknologjike
Shkencat mjekësore

- Në Seksionin e Shkencave Shoqërore Albanologjike, të ketë 4 komisione :

Gjuhë-letërsi

Histori-arkeologji

Shkencat sociale-juridike-ekonomi

Art - trashëgimi kulturore

3. Në zbatim të vendimit të Asamblesë nr.22, datë 18.10.2019, pika 4, neni 7 i Statutit, për hapjen e vendeve të reja në Asamble, fillon konsultimi për fushat përkatëse duke hedhur për diskutim variantin:

- **4-5 fushave në shkencat shoqërore dhe albanologjike:**

a) Në fushën e historisë të hapen:

- 1-2 vende

b) Në fushën e gjuhësisë të hapen:

- 1-2 vende

c) Në fushën e ekonomisë të hapen:

- 1 vend

- **3-4 fushave në shkencat natyrore teknike:**

a) Në fushën e fizikës të hapen:

- 1-2 vende

b) Në mjekësi hapet:

- 1 vend

c) Në inxhinieri të hapen:

- 1-2 vende

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

